



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit, Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr- 28/2008”, nenit 11, 15 dhe 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, konform, Vendimeve të Kuvendit Komunal në Suharekë të miratuar në vitin 2003, për ndarjen e shpërblimeve të cekura më poshtë, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, -----, miraton këtë:

## Projekt-V E N D I M

Për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve  
“Emblema e artë” dhe mirënjohjen “13 Qershori”

### Neni 1

Shpërblimi “**Emblema e artë**” i ndahet, **Bislim ZYRAPI** nga fshati Studençan Komuna e Suharekës.

### Neni 2

Mirënjohja “**13 Qershori**” i ndahet këtyre të nominuarëve: 1. Avdullah Melit MORINA nga fshati Samadrexhë, (postmortum) 2. Enver Malush ZEQAJ nga fshati Samadrexhë, (postmortum) 3. Shefki MUQA nga Suhareka (postmortum) 4. Afrim Dergut SYLAJ nga fshati Sllapuzhan dhe 5. Qazim N. MUSAJ nga fshati Samadrexhë.


### Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

## KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-\_\_\_\_\_  
Më datë\_\_\_\_\_

Kryesuesi i Kuvendit  
\_\_\_\_\_  
Mr.ec Bexhet KUÇI



## Procesverbal

z. Bexhet Kuçi, kryesues i komisionit, anëtarët prezent, Bulza Kuçi, Bajram Basha, Jehona Rrafshi, Festë Kabashi, Adem Bytyçi dhe Destan Zekolli, për pranimin dhe nominimin e propozimeve nga ana e qytetareve, institucioneve, shoqatave dhe kryesive të fshatrave për dhënien e shpërblimeve: „Emblema e Artë“, „Skënderbeu“ dhe mirënjohjes „13 qershori“ për vitin 2022, në emër të Komisionit për nominime, njofton anëtarët e Kuvendit të Komunës se propozimet për të nominuarit për shpërblimet e ditës së Çlirimit „13 qershori“ janë këto propozime:

### **“Emblema e Artë”**

1. ***Bislim ZYRAPI*** nga Studenqani -propozuesi- Kryetari i Komunës Bali MUHARREMAJ

### **“13 Qershori”**

1. Avdullah Melit Morina nga fshati Samadraxhë, propozuar nga OVL e UÇK-së dega në Samadraxhë
2. Enver Malush Zeeqaj nga fshjati Samadraxhë, propozuar nga OVL e UÇK-së dega në Samadraxhë
3. Halit Elshani nga fshati Samadraxhë, propozuar nga “Stacioni i Autobusësve” Xhemajli Shala
4. Shefki Muqa nga fshati Vraniq, propozuar nga OVL e UÇK-së dega në Suharekë
5. Hysen Gegaj nga fshati Sallagrazhd, propozuar nga OVL e UÇK-së dega në Suharekë
- 6 Qazim N. Musaj nga fshati Samadraxhë, propozuar nga Kryesia e Samadraxhesë
7. Afrim Sylaj nga fshati Sllapuzhan, propozuar nga Kryetari i fshatit Sllapuzhan

Më 10.05.2022

Kryesues i Komisionit

\_\_\_\_\_  
**Mr.ec Bexhet KUÇI**